


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR. 1161 REP

NR. 209 / 4 KOL

Jose e Jullu
u de ke...


KONTRATE SHITJEJE AKSIONESH

Sot, ne Tirane, me date 10 Mars 2006, perpara meje A. GJERMENI notere prane Dhomes se Noterise Tirane, u paraqiten personalisht palet:

SHITESI: Shoqeria "Ferlut" Sh.a, person juridik shqiptar, e regjistruar me vendimin nr. 23610, date 14.04.2000, te Gjykate se Rrethit Tirane, e perfaqesuar nga Aksioneri i Vetem i saj Z. Ferdinand Ibrahim, shtetas shqiptar, i biri i Luftiut, mbajtes i pasaportes me nr. Z1746093, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar. (qe ketu e meposhte do te quhet SHITESI)

BLERESI: Shoqeria "Al & Gi" shpk, person juridik shqiptar, e regjistruar me vendimin nr. 17467 date 22.07.1997, te Gjykates se Rrethit Tirane, e perfaqesuar nga Z. Alban Xhaferri, i biri i Ejupit, mbajtes i pasaportes me nr. 0868551, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.(qe ketu e meposhte do te quhet BLERESI)

Palet e mesiperme ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote te deklaruar dhe ne Vendimet e Asamblese se Ortakeve, te cilet ne vazhdim te kesaj kontrate do te quhen "Shitesi" dhe "Bleresi" me kerkuar hartimin e kesaj kontrate shtjeje aksionesh si me poshte:


Ekzistojne keto kushte paraprake:

Shitesi dhe Bleresi jane aksionere ne shoqerine "Birra Malto" sha dhe zoterojne perkatesisht secili: Shitesi zoteron 98,720 aksione ose 8.889% te kapitalit aksioner te paguar dhe Bleresi zoteron 98,719 aksione ose 8.889% te kapitalit aksioner te paguar te shoqerise "Birra Malto" sha.

Shoqeria "BIRRA MALTO" SHA eshte krijuar dhe vepron ne perputhje me Ligjin shqiptar dhe eshte regjistruar si person juridik me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane me nr. 19966 date 02.09.1998. Kapitali aksioner i shoqerise "Birra Malto" sha eshte ne shumen prej 1,110,550,000 leke dhe i ndare ne 1,110,550 aksione me nje vlere nominale prej 1.000 leke secili.

Sic rezulton nga vertetimi i marre nga Qendra e regjistrimit te aksioneve me nr 30 Prot date 09.03.2006 Shitesi eshte pronari ekskluziv dhe i vertete i 8.889% te kapitalit aksioner te paguar te shoqerise "Birra Malto" Sh.a. Me konkretisht Shitesi ka nen posedimin e tij ekskluziv dhe te pandashem 98,720 aksione me te drejte vote me nje vlere nominale prej 1.000 leke secila qe perfaqesojne 8.889% te kapitalit aksioner te shoqerise.

Bleresi eshte gjithashtu aksioner ne shoqerine "Birra Malto" sha dhe zoteron 8.889% te kapitalit aksioner te paguar ne kete shoqeri. Me konkretisht Bleresi ka nen





posedin e tij ekskluziv 98.719 aksione me te drejte vote me nje vlere nominale prej 1.000 leke secila qe perfaqesojne 8.889% te kapitalit te shoqerise.

Rezulton e provuar nga vertetimi i mesiperem se nga aksionet qe zoteron shitesi 97.585 aksione jane te bllokuara nga Tirana Bank. Keto aksione jane lene peng per efekt te huase te marre nga shoqeria "Ferlut" sha tek Tirana Bank sha.

Shitesi Shoqeria "Ferlut" sha ka bere paraprakisht kerkesen prane shoqerise "Birra Malto" sha, per shitjen 100%te aksioneve qe ai zoteron ne kete shoqeri, dhe kjo e fundit i ka kthyer pergjigje me shkresen me nr. 14/1 date 08.02.2006 se aksioneret nuk jane ne gjendje te blejne 100% te aksioneve te tij.

Me shkresen me nr protokolli _____ date _____ 2006 njeri nga aksioneret shoqeria "Al & GI" shpk, me cilesine e blesesit ne kete kontrate i kerkon shitesit te bleje 50% te aksioneve qe ai ka nxjerre ne shitje dhe shitesi pranon qe te shese 50% te aksioneve te tij me kushtet e meposhteme:

Bleresi deshiron te bleje dhe Shitesi deshiron te shese dhe te transferoje tek Bleresi **49,360 aksione** nga aksionet e siperpermendura qe ai zoteron ne shoqerine "Birra Malto" sha, ose 50% te aksioneve nga totali i aksioneve qe ai zoteron ne kapitalin aksioner, ne perputhje me kushtet, marreveshjet dhe cmimin si me poshte:

NENI 1 – OBJEKTI

Objekt i kesaj kontrate shitblerje eshte shitja nga Shitesi tek Bleresi i 49.360 aksioneve, te cilat perfaqesojne 50% te aksioneve qe zoteron shitesi tek shoqeria Birra Malto "sha ose 50% te kapitalit aksionere qe zoteron ai ne kete shoqeri, si dhe cdo lloj te drejte reale, personale si dhe interes pasuror te lidhur me keto aksione,ose me perqindjen e kapitalit aksionere qe ai shet sot , te drejta keto qe mund te vine tani ose ne te ardhmen duke njohur blesesin si te vetmin pronar ligjore.

Si dhe

Blerja e 49.360 aksioneve te shitesit qe perfaqesojne 50% te aksioneve qe zoteronte shitesi ne shoqeri (1/2 e 98,720 aksione) ose 50% e kapitalit aksionere te shitesit (1/2 e 8.889%) ne shoqerine "Birra Malto" si dhe cdo lloj te drejte reale, personale si dhe interes pasuror te lidhur me keto aksione,ose me perqindjen e kapitalit aksionere qe ai blen sot , te drejta keto qe mund te vine tani ose ne te ardhmen ,duke qene i vetmi pronar ligjore.

Pavec sa me siper palet bien dakorte qe objekt shitjeje me kusht te jene dhe 1/2 e aksioneve te permendura ne nenin 4/f,g,h pas plotesimit te kushtit te vene per to.neni 4 (Fitimi I gjyqit)

Shitja realizohet , konform vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "Ferlut" sha, te dates 20 Janar 2006 si dhe, Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "Al & Gi" shpk te dates 01.03.2006.



ENI 2 – CMIMI – MENYRA E PAGESES

Çmimi i shitjes se ketyre aksioneve eshte 400.000 EUR (katerqind mije eur). Pagesa do te behet ne disa keste ne shumet dhe menyren si me poshte vijon: Palet bien dakorte qe pronesia mbi **49,360 aksione** nga shitesi tek bleresi te kaloje vetem pasi te jete bere plotesishte pagesa .

1-Ne momentin e nenshkrimt te kesaj kontrate shitblerje, bleresi do ti paguaje shitesit shumen prej 300.000 EUR. (treqind mije eur). Nga kjo shume 200.000 EUR (te konvertuara ne dollare amerikane) do te derdhen ne llogarine e shitesit prane Tirana Bank me nr 0100-300292103 per efekt te shlyerjes se nje pjese te kredise qe shoqeria "Ferlut" sha ka tek "Tirana Bank" sha.

Shuma e mbetur prej 100.000 EUR do te terhiqet cash nga ana e Z. Ferdinant Ibrahim .Pagesa vertetohet me shkrese te thjeshte.

Ne momentin e derdhjes se kesaj shume nga bleresi ne llogarine e shitesit ky i fundit autorizon "Tirana Bank" sha qe te prek llogarine e tij per te marre shumen e mesiperme per efekt te shlyerjes se nje pjese te kredise qe ai ka ndaj Tirana Bank.

Me kalimin e kesaj shume nga llogaria e shoqerise "Ferlut" sha ne llogarine e Tirana Bank, kjo e fundit merr persiper qe ne menyre te menjehershme te c'blokoje, apo ate cliroje nga pengu 48.792 aksione ne favor te bleresit. Banka menjehere dorezon prane Qendres se Aksioneve nje deklarate noteriale per clirimin e aksioneve te mesiperme.



Faktin qe Banka merr persiper clirimin e menjehershem te aksioneve konfirmohet dhe me vertetimin e marre nga Tirana Bank me nr _____ date _____.


Qe ne kete moment shitesi dhe bleresi bien dakorte dhe autorizojne Qendren e Rregjistrimit te Aksioneve qe pas c'blokimit qe do tu beje Banka Tirana ketyre aksioneve , ato te bllokohen ne menyre te menjehershme, pa qene nevoja e nje akti tjeter per llogari te bleresit per efekt te pageses se kesit te pare qe ai ka bere 300.000 EUR. Palet bien dakorte qe te depozitohen per efekt te ketij bllokimi nje kopje te kesaj kontrate shitjeje prane Qendres se rregjistrimit te Aksioneve.

2- Kesti I dyte I pageses ne shumen 100.000 EUR (njeqind mije EUR) do te behet deri ne fund te muajit Prill 2006.Pagesa do te vertetohet me nje nga menyrat qe palet do te bien dakorte .Ne momentin e realizimit te pjeses se dyte te pageses shitesi firmos nje deklarate noteriale me anen e se ciles ai konfirmon marrjen e cmimit te shitjes se **49,360 aksione** aksioneve dhe kalimin e proñesise se tyre nga Shitesi tek Bleresi.

Palet bien dakorte qe te mos realizohet kontrate tjeter por mjafton kjo deklarate noteriale e cila do te depozitohet prane Qendres se rregjistrimit te Aksioneve per te bere kalimin e tyre nga shitesi tek bleresi

Pas pagimit te cmimit te shitblerjes Shitesi deklararon se e ka marre ate plotesishte dhe nuk ka asnje lloj pretendimi as tani dhe as ne te ardhmen ne lidhje e cmimin dhe me marjen e tij.





Palet bien dakorte qe ne cmimin e mesiperm jane perfshire dhe 1/2 e aksioneve te permendura ne nenin 4/ f,g,h pas plotesimit te kushtit te vene per to.(Fitimi I gjyqit)

NENI 3 - TRANSFERIMI I PLOTE I AKSIONEVE

Pronesia nga shitesi tek bleresi do te behet pasi te paguhet plotesishte cmimi i shitblerjes. Pas kesaj palet do te ndjekin procedurat perkatese per rregjistrimin e tyre ne emer te bleresit prane Qendres se rregjistrimit te Aksioneve dhe ne rast se bleresi deshiron prane Zyres se Rregjistrimit Tregetare ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

NENI 4 – TE DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITESIT SI DHE DEKLARATA E GARANCISE

Shitesi deklaron dhe garanton Bleresin qe:

- a. Ai zoteron 8.889% te aksioneve nominale me te drejte vote ne shoqerine "Birra malto "sha si dhe gezon te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe jane te lidhura me to;
- b. Pavec pengut te vendosura nga Tirana Bank nuk rezulton qe te kete persona te trete qe te kene pretendime mbi keto aksione, apo keto te jene te bllokuara dhe per efekt te ndoje subjekti tjetër. Keto aksione jane te lira karshi cdo detyrimi apo pretendimi te treteve te cfaredo natyre dhe ne pergjithesi nga cdo parregullsi ligjore. Shitesi ka zoterimin e plote dhe ekskluziv mbi to si dhe ka mbi to te drejta vote dhe preference si dhe nuk ka pale te treta te pretendojne mbi keto aksione pavec Tirana Bank ;
- c. Shoqeria ne te cilen shitesi eshte aksioner eshte e krijuar dhe vepron ne menyre te ligjshme sipas legjislacionit shqiptar;
- d. Kapitali aksioner i shoqerise sot eshte 1.110.550.000 leke dhe eshte i ndare ne 1.110.550 aksione me vlere nominale 1.000 leke secili dhe eshte plotesisht i paguar;
- e. Pas marrjes se cmimit,te shitblerjes , Shitesi Shoqeria "Ferlut" sha zhvishet teresisht nga pronesia mbi 49.360 aksione qe perfaesojne (1/2 e 8.889)% te kapitalit te shoqerise "Birra Malto" sha, Tirane si dhe mbi 1/2 e aksioneve te cilat atij i takojne nga procesi gjyqesor ne rast se fitohet . Shitesi humbet te gjitha te drejtat e pronesise mbi keto aksione,si dhe mbi cdo lloj te drejte reale, personale si dhe interes pasuror te lidhur me keto aksione,ose me perqindjen e kapitalit aksionere qe ai shet sot , te drejta keto qe mund te vine tani ose ne te ardhmen duke njohur bleresin si te vetmin pronar ligjore.
- f. Shitesi eshte ne dijeni se 10 nga aksioneret e shoqerise "Birra Malto "sha jane ne konflikt gjyqesore me shoqerine "Alb-Am"shpk duke kerkuar qe te njihen pronare mbi aksionet e ketij te fundit. Shoqerite paditese e kane kete pretendim per faktin se ne momentin e shitblerjes se 94% te aksioneve te shoqerise "Birra Malto "sha nga AKP , pjesa e te paditurit shoqerise "Alb-Am" shpk eshte paguar nga 10 aksioneret e tjere ne baze te nje marveshje te realizuar prej tyre .Njera prej shoqerive qe ka paguar 1/10 e cmimit te ketyre aksioneve eshte dhe shoqeria me cilesine e shitesit ne kete kontrate shitblerje " Ferlut "shpk.
- g. Shitesi deklaron se ne rast se gjyqi do te perfundoje ne favor te paditesave te cilet kane paguar aksionet e anes se paditur,dhe pjesa e "Alb-Am"shpk do te ndahet midis ketyre 10 shoqerive ne menyre te barabarte ashtu sic ata kishin rene dakorte qe ne marveshjen e dates 27.1.2001 ,pra ne rast se secila shoqeri do te perfitoje 1/10 e aksioneve te Alb -Am "shpk , gjysma-ketyre



aksioneve pra 50% qe do te perfitoje shoqeria "Ferlut" sha do te kaloje menjehere ne favor te shoqerise blerese "Al&GI" shpk duke u bere rregjistrimi ne emer te kesaj te fundit .Kjo per faktin se ne cmimin qe paguhet sot me kete kontrate shitblerje perfshihen pervec aksionet qe jane permendur me siper edhe 1/2 e aksioneve qe do te perfitoje ne te ardhmen shoqeria "Ferlut" shpk nga shoqeria ""Alb- Am" shpk

- h. Ne rast se ky gjykim do te mbaroje ne favor te 10 shoqerive shqiptare te cilet jane paditesit , kjo kontrate e nenshkruar sot eshte plotesishte e vlefshme edhe per kalimin dhe transferimin e pronesise se 1/2 se aksioneve qe do te perfitoje shoqeria "Ferlut" shpk nga ky proces gjyqesore ne favor te bleresit "Al &Gi" shpk pa qene nevoja e berjes se nje akti tjetër noterial ,mjafton vendimi i gjykates , dhe shitesi heq dore qe sot nga pronesia mbi keto aksione duke njohur bleresin si pronarin e vetem ligjore te tyre , kjo per faktin qe u permend me siper qe cmimi i tyre eshte perfshire ne cmimin e paguar ne kete kontrate
- i. Bleresi do te bleje dhe do te zoteroje aksionet si me siper,dhe te drejtat e lidhur me to mbeshtetur plotesisht ne deklaratat e garancise te Shitesit te cilat cilesohen qe merren persiper, kane vlere dhe detyrojne Shitesin per ate periudhe kohore nga momenti i nenshkrimt te kontrates konkrete deri ne transferimin e plote te aksioneve si dhe pas permbushjes se detyrimeve te paleve.
- j. Shitesi deklaron se dhe bashkeshortja e tij ka dijeni te plote per kete shitje aksionesh , per kete transaksion, cmimin , menyren e berjes se pageses si dhe per kalimin ne te ardhmen te 1/2 se aksioneve ne favor te bleresit ne rast se procesi gjyqesor perfundon me sukses.

Shitesi i deklaron Bleresit se me zhveshjen e tij teresisht nga pronesia e 49.360 aksioneve qe perfaqesojne (1/2 e 8.889%) te kapitalit themeltar te Shoqerise "Birra Malto" sha dhe me humbjen e te gjitha te drejtave te pronesise mbi keto aksione, te cilat kalojne ne pronesi te Bleresit, heq dore nga cdo pretendim pronesie, te drejte reale, personale dhe interesa pasurore qe kane lidhje me keto aksione si tani dhe ne te ardhmen apo pretendim te cdo lloj natyre tjetër lidhur me keto aksionet dhe te drejtat e lidhura me to .

Me realizimin e kesaj shitjeje Shitesi (Shoqeria "Ferlut" sha) mbetet aksioner ne shoqerine "Birra Malto" sha duke zoteruar vetem 49.360 aksione qe perfaqesojne 4.444,5% te kapitalit aksionere te shoqerise dhe Bleresi behet zoterues i 148.079 aksioneve qe perfaqesojne 13.333,5% te kapitalit aksioner te shoqerise "Birra Malto" sha.

Neni 5 – BAZA LIGJORE

Kontrata u hartua dhe u redaktua bazuar ne Ligjin Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", Statutit te shoqerise "Birra Malto" sha dhe Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

Neni 6 : ZGJIDHJA E KONTRATES

Asnje nga palet nuk ka te drejte te prishe kete kontrate ne menyre te njeanshme :

Ne rast se blesesi nuk paguan cmimin (kestin e dyte) ne afatin e caktuar ne kete marveshje ateherë ai duhet te ulet me shitesit per te caktuar nje afat tjetër te mundshëm .

Pamundesia e berjes se pageses se keshtit te dyte pasi ka kaluar nje afat dy mujore (pamundesia kjo e krijuar nga rethana te cilat blesesi nuk i dinte ose nuk kishte si ti dinte ne momentin e berjes se kesaj kontrate shitjeje) nuk i jep te drejte shitesit te zgjidhe kontraten , por blesesi do te behet pronarë i nje numri te caktuar aksionesh te barabarta me shumën e paguar .Ne keto kushte shitesit deklaron qe nga ky moment se eshte dakorte qe te kaloje pronesia nga shitesit tek blesesi per aq aksione sa blesesi ka paguar , duke marre per baze vlerën nominale te aksioneve sipas Statutit te shoqerise.

Neni 7 :EFEKTI I FORCES MADHORE

Palet do te mundohen te permbushin detyrimet e tyre sipas kushteve te rena dkorte ne kete kontrate. Ne rast se keto detyrime nuk permbushen per shkak te forcave madhore ose shkaqeve te tjera te pavaruara nga palet ,keto te fundit do te shtyne datën e ekzekutimit te detyrimit aq dite sa ekziston forca madhore apo sa te zhduket shkakun qe solli pengimin e ekzekutimit te detyrimit .

Neni 7 – VLEFSHMERIA E KONTRATES

Kontrata hyn ne fuqi dite e neshkrimit te saj nga te dy palet.Kjo kontrate eshte e vlefshme dhe per trashegimtarete ligjore te paleve .

Kontrata i detyron palet t'u permbahen kushteve te vendosura ne te.

Ne rast konflikti palet do te mundohen ti zgjidhi ato me mirekuptim ne te kundert kompetente eshte gjykata e rrethit Tirane. Aksionet qendrojne te bllokua deri ne momentin e zgjidhjes se konfliktit .

Kjo kontrate hartohet ne 4 (kater) kopje origjinale te njejta. Kjo kontrate u hartua dhe u redaktua ne prezence te paleve, iu lexua me ze te larte dhe palet pasi e degjuan, e kuptuan, deklaruan se e gjejne ate ne perputhje te plote konform vullnetit te tyre te lire, ne prezencen time e pranuan aktin dhe e nenshkruajne ate pa verejtje dhe une Noterja e vertetoj rregullisht sipas ligjit.

P A L E T

SHITESI

Shoqeria "FERLUT" SHA
Perfaqesuar nga:

Z. Ferdinant Ibrahim

Bashkeshortja
Znj. Olimbi Ibrahim

Olimbi Ibrahim

[Signature]

-BLERESI

Shoqeria "Al & Gi" shpk
Perfaqesuar nga:

Z. Alban Xheferi

AL - GI
CONSTRUCTION
CEL: 069 2032217

NOTERE

Alban Xheferi
[Signature]